



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 01.12.2016, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Flamur Shala (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS), Abit Kastrati dhe Cuneyd Ustaibo (KDTP).

Munguan:, Blerand Stavileci (PDK) dhe Shaip Shabani (PDK).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Qëndron Kastrati kërkoi nga kryesuesi që të mbahet një minutë heshtje për vdekjen e një qytetari të Prishtinës (Astrit Dehari), i cili ka qenë i arrestuar politik dhe është mbajtur padrejtësisht në burg, është marrë në pranga dhe është kthyer i vdekur.

Kryesuesi shprehu bindjen se të gjithë e ndajnë dhimbjen për humbjen e jetës së Astritit dhe përkrahu propozimin për të mbajtur një minutë heshtje.

Qëndron Kastrati njëherësh propozoi që betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit, të bëhet para se të fillohet me rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan propozimet e z. Qëndron Kastratit.

Kryesuesi e propozoi edhe një pikë të rendit të ditës “Vendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete”, i cili ndryshon, ngase në Komitetin për Komunitete tashmë mungon znj. Lirijeta Rexhepi.

Kryesuesi e ftoi znj. Egzona Podvorica, anëtare e PDK-së, që ta bëjë betimin para anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesi Konstatoi se me 45 (dyzet e pesë) vota për, 1 (një) abstenim (Abetare Fazliu), u miratua ky

R E N D I I D I T Ë S:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Shqyrtimi i raportit nëntëmujor buxhetor, janar-shtator, për vitin 2016;
3. Shqyrtimi i Propozimvendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Qendrës së Arteve të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Propozimvendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Kuvendit të Motrave të Shën Kryqit;
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për Kompaninë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
7. Propozimvendimi për miratimin e planit për vendosjen e qoshqeve;
8. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe;
9. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Komunës.

Agim Gashi bëri vërejtje në ekstrakt, në pikën e pestë, i cili tha se unë nuk kam propozuar që Komuna të angazhohet në ndërtimin e një deponie të mbeturinave për deponimin e mbeturinave komunale, por kam propozuar që të zgjerohet shërbimi për grumbullimin e mbeturinave në të gjitha vendbanimet e mundshme të komunës. Gjithashtu, lidhur me hartimin e ekstraktit të procesverbalit dhanë vërejtje: Lirak Çelaj, Sylejman Pireva dhe Halim Halimi.

Kryesuesi konstatoi se më 32 (tridhjetë e dy) vota për, 2 (dy) vota kundër, (Lirak Çelaj dhe Sylejman Pireva) dhe 10 (dhjetë) abstenime, (Hatixhe Hoxha, Naime Osmani, Qendron Kastrati, Brahim Mehmetaj, Fadil Gashi, Halim Halimi, Imer Rusinovci, Egzona Podvorica, Muhamet Selmani dhe Shemsi Veseli), u miratuan procesverbalet e mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit.

Pika e dytë

Shqyrtimi i raportit nëntëmujor buxhetor, janar-shtator, për vitin 2016.

Kryetari, Shpend Ahmeti, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth përgatitjes së këtij raporti, duke theksuar se ky raport është përgatitur në bazë të neni 45.4 të Ligjit për financat publike në Republikën e Kosovës.

Sokol Krasniqi theksoi se investimet kapitale janë 1 milion më pak se në vitin e kaluar, gjë që është një shqetësim real për pritjet e qytetarëve të Prishtinës që i kanë pasur për projektet e planifikuara për vitin 2016. Një zhgënjim i tillë është shumë i theksuar, sidomos në investimet në projektet kapitale, gjë që asnjë projekt i cili është pritur me padurim nga qytetarët, si në kulturë, urbanizëm, kadastër, planifikim dhe zhvillim ekonomik, bujqësi etj. d.m.th. mungojnë si të tilla.

Kreshnik Ahmeti tha se ky raport paraqet një reflektim të zhvillimit të komunës dhe qeverisjes, e këtë e shohim edhe tek të hyrat, për shkak se kemi një dallim të madh cilësor tek realizimi i të hyrave. Po të mos kishte investime, nuk do të kishim realizim të tillë të të hyrave. Ne si GP do ta mbështesim këtë raport.

Muhamet Selmani u shpreh se, në krahasim me vitin paraprak, të hyrat nga tatimi në pronën e paluajtshme kanë qenë shumë mirë të organizuara. Një shqetësim i vazhdueshëm që na përcjell tash e tri vjet, janë investimet kapitale, një trend shumë i ultë i realizimit të investimeve kapitale, sidomos ndërtimet e shkollave në disa lagje të qytetit, që janë më se të domosdoshme, që ka qenë një nga premtimet, ndërtimi i çerdheve, ndërtimi i këndeve të lodrave, furnizimi me libra etj. Një premtim ka qenë për ujë 24 orë në Prishtinë, nuk është realizuar, shtrirja e rrjetit për ngrohje, nuk po e shoh që është alokuar. Po ashtu, trajtimi i mbeturinave, subvencionet për bujqësi, nuk është realizuar asnjë projekt në këtë drejtim. Sa i përket Drejtorisë së Mirëqenies

Sociale dhe Shëndetësisë, është për t'u lavdëruar, e cila pothuajse e ka shfrytëzuar buxhetin rekord. Një shqetësim tjetër që duhet të ceket, janë mjetet që nuk janë shpenzuar për harta gjeodezike, kadastër e gjëra të tjera, sidomos që jemi në fazën kur ne duhet të planifikojmë hartat zonale të qytetit.

Sami Boroci, në emër të GP të AKR-së, tha se e kemi shqyrtuar raportin e paraqitur nga kryetari, kemi disa komente lidhur me mosrealizimin, ose ngecjen e realizimit të disa projekteve, mirëpo në parim do ta mbështesim.

Imer Rusinovci tha se GP i AAK-së në parim e mbështet këtë raport. Në sektorin e bujqësisë nuk janë shpenzuar mjetet konform planifikimit që është bërë. Ideja është se ato janë prolonguar për ca kohë, për vetë faktin që mos të përsërisim kritere të dyfishta. Jam i bindur se në tremujorin e fundit ato do të jenë të përfshira në këtë buxhet.

Kimet Zeqa theksoi se edhe ne në parim e përkrahim këtë raport.

Abetare Fazliu u shpreh se edhe LB-ja e përkrah këtë raport, por investime më të mëdha duhet të bëhen në kulturë, rini, sport dhe në arsim.

Visar Arifaj, shprehu mendimin se të hyrat që i ka realizuar Komuna, në përgjithësi janë të kënaqshme. Lidhur me shpenzimet kapitale, ai kërkoi sqarim nga ekzekutivi se pse kanë ngecur me realizim.

Nenad Miladinovic e përkrahu raportit nëntëmujor buxhetor, janar-shtator, për vitin 2016.

Kryetari, Shpend Ahmeti, sa i përket realizimit të projekteve, theksoi se po hasim në disa pengesa nga Qeveria, e cila nuk po na mundëson që këto projekte të realizohen. Komunës së Prishtinës nuk po i bëhet kompensimi për pronat që i ka marrë Qeveria, dhe për këtë kemi deponuar edhe padinë në gjykatë. Kemi dërguar përmbarues, që t'i mbledhim d.m.th., sepse bëhet fjalë për diku 7 milionë euro, të cilat nuk janë paguar dhe nuk merren parasysh që t'i paguajnë.

Lirak Çelaj tha se ajo që është më shqetësuese, është shpenzimi i mjeteve, që paraqet performancën reale të një qeverisjeje, sepse mos shpenzimi nënkupton dështime të projekteve që i kanë paraparë vetë. Shpenzimet në investime kapitale janë 1 milion e 100 mijë më pak dhe në total shpenzimet janë më pak sesa në vitin e kaluar. Nuk ka filluar ndërtimi i shkollave në lagjet: "Kalabria", "Sofali", "Veternik" dhe "Mati 1", projekti për ndërtimin e Shkollës së Muzikës, projekt i cili deri më tani nuk është realizuar. Trotuari në qendër, d.m.th. në rrugën "Agim Ramadani" është bërë qesharak, "Kurrizi", pothuajse kemi hyrë në vitin e dytë të realizimit të atij projekti dhe nuk po përfundon etj.

Agim Gashi u shpreh se ky dokument është njëri ndër dokumentet më të rëndësishme që kalon nëpër Kuvend, i cili do të duhej të ishte sa më i përkryer edhe në aspektin teknik. E përkrahu përmirësimin e titullit, dhe sugjeroi që të hyrja dhe te faqja 7, të përmirësohet shprehja "nëntëmujori i tretë", sepse nuk ka nëntëmujor të tretë, ka tremujor të tretë. Sa u përket investimeve kapitale, është shqetësuese, sepse mungojnë projektet e vlerave të mëdha, për të cilat Prishtina ka shumë nevojë, siç janë investimet në kolektor, investimet në ndërtimin e objekteve shkollore, që mund t'i quaj projekte të vlerave të mëdha.

Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se në investimet kapitale do të kemi minus, për shkak se të hyrat janë më të vogla sesa që kanë qenë të planifikuara. Çështja është se nuk mund t'i realizojmë disa investime, për shkak të mungesës së buxhetit dhe pa ndihmën e Qeverisë.

Flamur Shala lidhur me raportin, tha se do të duhej të bëhej një krahasim me raportet paraprake, por kjo nuk është bërë, përkundrazi, ka pasur rënie dhe ato rënie kanë qenë eklatante krahasuar me trendin. Sa i përket investimeve kapitale në Drejtorin e Infrastrukturës dhe Menaxhimit të Kontratave, brenda këtij programi kanë qenë projektet të cilat është dashur të realizohen, e që kanë të bëjnë edhe me ndërtimin e shkollave, rrugëve dhe kolektorëve, por asnjë nga këto nuk janë realizuar.

Shemsi Veseli theksoi se këtij raporti, pavarësisht që është përshkrues, i mungon përshkrimi, i mungojnë rezultatet, i mungojnë konkluzionet, përfundimi dhe rekomandimet, por edhe sfidat që do të duhej tejkualuar. Në raport nuk janë përfshirë aktivitetet e ndërmarra në periudhën raportuese, se cilat janë të arriturat, cilat janë vështirësitë e paraqitura në këtë periudhë dhe cili është plani për tremujorin e fundit të vitit 2016.

Mustafë Krasniqi pati reagim ndaj fjalës së drejtorit të Infrastrukturës dhe ndaj akuzave që drejtori i drejtoi në adresë të nivelit qendror, apo ministrive përkatëse, se nuk është bërë asnjë investim në komunën e Prishtinës. Ai u shpreh se unë kam qenë në cilësinë e qytetarit, por edhe si asamblist i këtij Kuvendi, që i kam bërë ftesë disa herë edhe kryetarit, edhe drejtorit, që t'u drejtohen ministrive përkatëse, konkretisht Ministrisë së Infrastrukturës, për nevojat që i ka kryeqyteti në fushën e infrastrukturës.

Syelejman Pireva tha se i bashkëngjitëm vërejtjes që u dha rreth formës së punimit të raportit, ku përveç anës teknike, ka nevojë t'i kushtohet rëndësi edhe referencave. Për këtë arsye janë fusnotat, ku në momentin që ka nevojë për sqarime, ato mund të jepen në fund të faqes, në mënyrë që mos të ketë hapësirë për të dhënë vërejtje kritike rreth kësaj. Do të ishte mirë që në të ardhmen të plotësohet edhe kjo formë.

Ylli Hoxha ngriti një shqetësim, duke thënë se një prej problemeve madhore në këtë tabelë buxhetore, është arkëtimi i të hyrave nga legalizimi i objekteve pa leje. Janë planifikuar 5 milionë euro, kemi realizuar 400 mijë euro, dhe nuk besoj që deri në fund të vitit mund të kalojmë në 500-600 mijë euro në situatën më të mirë, do të thotë kemi realizim së paku pesëfish më të ulët se planifikimi. Andaj, kjo çështje është një prej problemeve të mëdha financiare, por edhe parimore.

Shefki Gashi theksoi se gjendja është alarmante, rrugët e qytetit janë vjetruar, të papastra dhe me gropa. Kemi diku 27 fshatra, vendbanime pa ujë teknik, pa ujë të përpunuar, andaj kërkoj që këto çështje të merren parasysh.

Brahim Mehmetaj tha se Komuna e Prishtinës duhet të punojë në lehtësimin e çështjes së aplikimit, ose çështjen e marrjes dhe përfundimit të legalizimit. Është shumë më problem numri i dokumentacionit që kërkohet për legalizim dhe procesi për kryerjen e atij dokumentacioni është i rëndë. Unë kërkoj nga Komuna që të bëjë, apo të kërkojë sa më pak dokumente, që të mundësohet legalizimi i shtëpive të qytetarëve.

Kryesuesi konstatoi se më 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota për, 19 (nëntëmbëdhjetë) vota kundër (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Fisnik Osmani, Flamur Shala, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Hazir Borovci, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Egzona Podvorica, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi dhe Shemsi Veseli), nuk u miratua Raportit nëntëmujor buxhetor, janar-shtator, për vitin 2016.

Pika e tretë

Shqyrtimi i Propozimvendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Qendrës së Arteve të Kosovës.

Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, theksoi se prona e cila propozohet t'i jepet në shfrytëzim Qendrës së Arteve të Kosovës, gjendet në Zonën kadastrale "Nëntë Jugoviq", me një sipërfaqe prej 20 arë, në të cilën gjenden dy objekte. Këtë pronë Qendra e Arteve e ka pasur në shfrytëzim qe dhjetë vjet, në bazë të kontratës, dhe tash është kërkuar që kjo pronë t'u jepet prapë në shfrytëzim. Kryetari ka propozuar që t'u jepet për 15 vjet, pa kompensim. Qëllimi i shfrytëzimit për të cilën kanë kërkuar, është ushtrimi i aktiviteteve kulturore në ato objekte.

Sami Boroci tha se ne si grup jemi dakord, mirëpo e kemi vetëm një propozim. Propozojmë që në kuadër të kësaj hapësire, të shfrytëzohet edhe një hapësirë për bibliotekë dhe për shtëpi të kulturës, që ekzekutivi, së bashku me drejtorinë përkatëse, të shohin mundësinë e krijimit të këtyre dy hapësirave që janë të nevojshme.

Kryesuesi tha se paraprakisht duhet me qenë propozimi i kryetarit. Propozimin e kryetarit nuk e kemi për atë shtesë, andaj ky propozim nuk mund të procedohet më tutje.

Shemsi Veseli tha se përfaqësuesi nga Qendra e Arteve të Kosovës e ka bërë me kohë kërkesën, dhe në bazë të një kontrate që është miratuar faktikisht në vitin 2006, shkruan qartë, neni 8 i kontratës, se dhjetë ditë para se të skadojë afati, duhet të vendoset për përgjigje pozitive apo negative. Më habit fakti se plot gjashtë muaj bëhen që ka skaduar kjo kontratë, pra problemi d.m.th. nuk qenka tek ky Kuvend, por qenka tek ekzekutivi.

Në parim unë jam me iu vazhduar, nuk jam kundër kësaj, por më shqetëson fakti që në heshtje po shkelen ligjet edhe rregulloret.

Kryesuesi konstatoi se më 25 (njëzet e pesë) vota për, 4 (katër) abstenime, (Lirie Avdiu, Egzona Podvorica, Muhamet Nura dhe Muhamet Selmani), u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Qendrës së Arteve të Kosovës.

Pika e katërt

Shqyrtimi i Propozimvendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Kuvendit të Motrave të Shën Kryqit.

Kryetari, Shpend Ahmeti, theksoi se është fjala për Konviktin te Kisha katolike, në lagjen "Ulpiana", ku është kërkuar që t'i vazhdohet shfrytëzimi i pronës edhe për një periudhë të caktuar. Propozimi është që kjo t'i jepet në shfrytëzim për 99 vjet.

Shemsi Veseli në parim u shpreh për vazhdimin e dhënies së pronës në shfrytëzim, por kishte një dilemë rreth afatit të vazhdimit për dhënien në shfrytëzim të objektit.

Sadri Ramabaja u shpreh se ne si Grup parlamentar e kemi diskutuar dhe jemi pajtuar plotësisht. Unë kisha bërë ftesë që jo vetëm në këtë rast, por edhe kërkesat e tjera që vijnë

prej këtyre komuniteteve, t'i kemi parasysh, të jemi sa më zemërgjerë, pasi që ligji veç po e parasheh këtë afat për 99 vjet.

Flamur Shala tha se edhe Grupi ynë parlamentar e ka pranuar dhe sigurisht se do të votojmë për miratimin e këtij propozimvendimi.

Kryesuesi konstatoi se më 27 (njëzet e shtatë) vota për dhe 3 (tri) abstenime, (Shaip Hajrizi, Lirak Çelaj dhe Naime Osmani), u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës – Kuvendit të Motrave të Shën Kryqit.

Pika e pestë

Shqyrtimi i Propozimvendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se në Kuvend do të sjellim propozime për këmbimin e pronave që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve të ndryshme, ku parashihet ndërtimi i ndonjë rruge, parku etj., por që ato janë prona private, andaj ne duhet të bëjmë këmbimin e pronës, në mënyrë që t'i realizojmë planet rregulluese sipas planeve në fuqi.

Agim Gashi u shpreh në përkrahje të këtij propozimvendim.

Lirak Çelaj theksoi se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim.

Kryesuesi konstatoi se më 28 (njëzet e tetë) vota për, 1 (një) abstenim, (Naime Osmani), u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për Kompaninë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Kryetari, Shpend Ahmeti, theksoi se ka ardhur një interpretim prej Zyrës ligjore, ku thuhet se ligji e parasheh, për pronat që i merr KEDS-i të mos paguhet qira.

Ne si ekzekutiv pajtohemi që në parim ishte dashur të kompensohet, për shkak se është kompani fitimprurëse.

Agim Gashi shprehu mendimin se do të ishte mirë që ne ta votojmë këtë, por t'ia kushtëzojmë që ata të marrin përgjegjësinë e investimit dhe mos t'i ngarkojë qytetarët me participim. Në një mënyrë, si kompensim që ne po e japim tokën pa pagesë në një periudhë derisa të rregullohet ndryshe.

Qëndron Kastrati theksoi se edhe ne si Grup parlamentar mendojmë, nëse pajtohen edhe të tjerët, që kryetari, në bashkëpunim me kryesuesin, të vendosin që kjo çështje t'i drejtohet me shpresë për trajtim Kuvendit të Kosovës.

Muhamet Selmani tha se në këtë rast, toka ka të bëjë vetëm me shfrytëzimin e vendosjes së trafos, pra toka jepet vetëm për vendosjen e asetit të KEDS-it.

Flamur Shala theksoi se sa i përket pronës, duhet të jetë në shfrytëzim për aq kohë sa do të jetë trafoja aty dhe duhet të menaxhohë KEDS-i.

Ardian Olluri bëri të ditur se këtu kemi të bëjmë me një ligj të ri, që ka hyrë në fuqi në korrik të këtij viti, i cili obligon komunat me i lejuar qasje operatorit për vendosjen e trafove. Është e vërtetë që trafoja është e vendosur në një oborr, andaj pronari i asaj shtëpie ka kërkuar që me iu larguar, dhe është në procedurë e sipër.

Ylli Hoxha shprehu mendimin se do të kishte qenë mirë që Komuna dhe KEDS-i të kenë një marrëveshje, sipas së cilës do të parashihej që për token që shfrytëzohet nga KEDS-i, të kompensohet me energji elektrike, e cila është pronë e saj, e që e vetmja mundësi me i detyruar do të jetë ky vendim. Nuk po shihet se jemi të gatshëm së paku të mendojmë që kur të na vjen herën tjetër, ta mendojmë mirë dhe ta bëjmë një hap në këtë drejtim.

Shemsi Veseli u shpreh se, meqë është në interes publik, nuk ishte dashur që të mos merret vendim, prandaj munden me u detajuar këto gjëra dhe nuk kemi nevojë të diskutojmë.

Kryesuesi konstatoi se më 25 (njëzet e pesë) vota për, 8 (tetë) abstenime, (Hatixhe Hoxha, Hatixhe Latifi Pupovci, Kreshnik Ahmeti, Qëndron Kastrati, Remzi Pacolli, Sadri Ramabaja, Sylejman Pireva dhe Teuta Krasniqi), u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për Kompaninë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Pika e shtatë dhe e tetë

Propozimvendimi për miratimin e planit për vendosjen e qoshqeve dhe Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe.

Kryetari, Shpend Ahmeti tha se me këtë proces parashihet modernizimi i të gjithë infrastrukturës së qoshqeve. Për këtë i kemi marrë edhe disa praktika, modele nga shtete e rajonit, dhe do të jenë qoshqe të dizajnuara më mirë dhe më funksionale se ato që janë në shfrytëzim.

Agim Gashi bëri të ditur se në vitin 2014 është nxjerrë një rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, andaj do të ishte mirë që ne të thirremi në atë rregullore. Si Grup parlamentar mendojmë që, meqenëse nuk janë kryer paraprakisht këto punë, të shtyhet për një mbledhje të ardhshme.

Qëndron Kastrati tha se edhe ne si Grup parlamentar i përkrahim këto dy pika. Mendojmë dhe kemi dëshirë që të përfshihemi në politikat e shpërndarjes së tyre, por për këtë fazë jemi dakord dhe do të votojmë për të dy çështjet.

Lirak Çelaj u shpreh se në parim jemi për vënien e një rregulli dhe e mbështesim riorganizimin, sepse ka shumë qoshqe të cilat nuk janë shpërndarë mirë, d.m.th. diku ka shumë, diku ka më pak, e disa nuk janë funksionalizuar asnjëherë.

Besoj se na duhet edhe pak kohë, në mënyrë që të na prezantohet më mirë vendi se ku kanë me u vendosur.

Mirlinda Sopi shprehu qëndrimin e grupit për miratimin e këtij plani në parim, sepse në Prishtinë ka shumë qoshqe të cilat nuk janë të organizuara mirë, edhe nga aspekti estetik duken keq, ku rreth tyre ka grumbuj mbeturinash dhe pajisje të tjera që po i japin qytetit një pamje të keqe.

Kimet Zeqa, theksoi se edhe ne si Grup parlamentar në parim jemi për miratimin e këtij propozimvendimi.

Abetare Fazliu e përkrahu miratimin në emër të LB-së.

Visar Arifaj pyeti se dizajni a ka me qenë si pjesë e rregullores, që mos me qenë ajo vetëm kontratë në mes Komunës dhe palës tjetër, por me qenë uniforme për krejt.

Nenad Miladinoviqi, në emër të subjektit të tij e përkrahu miratimin e propozimvendimit.

Shefki Gashi e përkrahu propozimin, që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, por në momentin kur të miratohen, duhet pasur parasysh që ato qoshqe ta kenë një standard të nivelit më të mirë dhe të dihet destinacioni i tyre se për çka jepen në shfrytëzim.

Shemsi Veseli theksoi se ne kemi diskutuar në vitin 2005, kur kemi thënë se një kategori të njerëzve u është bërë padrejtësi, ish-punëtorëve të Rilindjes, sepse atëherë ato qoshqe kanë qenë pronë e ish-ndërmarrjes "Rilindja". Kemi marrë qëndrim që të përkrahet një kategori që i kishin kushtet e vështira sociale. Për shkak të politikës sociale ndaj atyre individëve që kanë të vetmin burim të jetës punën në qoshk, mendoj se këto raste duhet pasur parasysh me rastin e ndarjes së qoshqeve.

Flamur Shala shprehu mendimin se atyre që u kanë kaluar kontratat për punën në qoshqe, e të cilët duhet të hyjnë në konkurrencë, Komuna duhet t'i ketë parasysh që ta kenë përparësinë për t'i marrë ato kioska në shfrytëzim. Kjo është esenciale, sepse ne nuk duam të krijojmë kushte që ana sociale e këtyre njerëzve të dëmtohet, sepse jam i bindur që shumica dërmuese prej tyre e kanë të vetmin burim financiar.

Ajnishahe Azemi u shpreh e pajtimit me mendimin e kryetarit, për ta sjellë dhe për ta parë se si është bërë plani, ndoshta do të ketë mundësi t'i shohim më mirë ku do të jenë të vendosura dhe sa janë funksionale ato sipas asaj që i ka planifikuar Urbanizmi.

Ylli Hoxha shprehu mendimin se nuk duhet bllokuar këtë proces, por duhet të punojmë që t'i administrojmë këto kërkesa, të cilat janë legjitime, por aq legjitime është edhe kërkesa e Visarit që ta shohim edhe dizajnin. Nuk besoj se kemi problem parimor rreth kësaj çështjeje nga ana e ekzekutivit, që të na e mohoj atë të drejtë. Ju inkurajoj që ta japim këtë aprovim dhe ta administrojmë po në atë drejtim, sepse nuk jemi në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Remzi Pacolli kërkoi të dijë se a i plotëson ato kushte, kur mendoni me e ndryshuar Rregulloren, që nga 15 me e bërë 18 m². A është e përcaktuar se çka mund të shitet në ato kioska, apo e merr dhe e përdor dikush e qel një bankë, dikush e qel qebaptore, a është e obliguar se çka duhet me përmbajtur ato objekte?

Sylejman Pireva tha se vendosja e kioskave nuk është e njëjtë si në shesh të Prishtinës, si në lagjen "Kodrën e Trimave", prandaj kjo çështje duhet të rregullohet, sepse nuk bëhet punë e njëjtë. Përpara ka mundur të thotë, paguhen me rroga të Komunës punëtorët, e fitimi qysh e si është llogaritur ndryshe, sot do të thotë rroga do të jetë sipas realizimit që bën ai me punën që e kryen, apo jo? Këtë po e lypsi si një informatë kështu, se nuk e kam të njohur, të ju them të drejtën. Janë këto çështje që unë kisha dashur të mos dal nga ky Kuvend pa i njohur dhe pa i ditur.

Kryetari, Shpend Ahmeti, duke u bazuar në diskutimet e parafolësve, propozoi që kjo pikë të shtyhet dhe të procedohet në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Kryesuesi theksoi se në bazë të propozimit të kryetarit dhe anëtarëve të Kuvendit të cilët diskutuan, kjo pikë shtyhet dhe do të procedohet në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete.

Lirak Çelaj kërkoi nga kryesuesi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, pasi që duhet kohë për ta diskutuar.

Kryesuesi konstatoi se Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Pika e dhjetë

Pyetje dhe përgjigje.

Hatixhe Latifi - Pupovci, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Në një takim të mbajtur me Shoqatën e Grave të Verbra të Kosovës, për mos zbatimin e ligjit nga operatorët privatë të transportit publik, kisha dashur që tash e tutje Komuna e Prishtinës të ndër marrë masa për zbatimin e ligjit nga këta operatorë, që personat e verbër të transportohen pa pagesë. Gjithashtu, Komuna e Prishtinës me rastin e punësimit të personave të verbër, në qoftë se i plotësojnë kushtet, të kenë përparësi në raport me personat e tjerë.

Muhamet Selmani, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Kërkoj nga drejtori t'i kemi informatat rreth përgatitjeve që janë bërë për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin e dimrit; sa kontrata janë nënshkruar për këtë punë, çfarë kapaciteti kanë operatorët, kush janë ata dhe cilat janë përgatitjet?

Agim Gashi, pyetje për Drejtorinë e Financave.

Meqenëse në raportin e auditorit kam vërejtur që shërbimet përkatëse kanë bërë shumë pagesa kontigjente, ose pagesa pa procedurë prokurimi, GP i LDK-së, kërkon që për vitet 2015 dhe 2016, të na dërgohet lista e pagesave dhe qëllimi i atyre pagesave, në mënyrë që të informohemi se pse dhe çfarë është bërë në atë drejtim.

Shaip Hajrizi, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Pyetja e parë është se, trotuaret i kemi të mbyllura në shumë vende, e sidomos rruga tek ABC-ja, prej sheshit e deri te policia. Më intereson ta dijë se ata shfrytëzues a paguajnë për komplet trotuarin dhe qytetari duhet ecur rrugës duke u rrezikuar apo, siç ka qenë më herët, që është lëshuar gjysma e trotuarit, dhe gjysma tjetër ka qenë e lirë.

Pyetja e dytë është se, autobusët të cilët ndalen te Xhamia e Llapit, rrinë ndezur, lëshojnë tym dhe i pengojnë lokalet me i hapur dyert në kohën kur është vapë. A është ndërmarr diçka, se pse autobusët ende veprojnë njësojë? Këtë shqetësim e kam ngritur edhe më herët.

Dhe një pyetje, që kam biseduar edhe me kryetarin drejtpërdrejt, edhe me nënkryetarin, është një kërkesë e punëtorëve të ndërmarrjes "Taifor". Kjo kompani tash e 6 muaj nuk ua jep rrogat këtyre

punëtorëve dhe si është e mundshme mos me penguar kjo çështje Komunën? Punëdhënësit e kësaj kompanie punëtorëve ju thonë se Komuna nuk po na i lëshon mjetet. Kjo çështje nuk e di a është për neve këtu a jo, por unë mendoj që po, sepse Komuna e bënë kontratën me atë kompani dhe meqenëse e bënë kontratën, duhet edhe me e pas mbikëqyrjen se si po vepron ajo kompani me punëtorë. Unë jam i obliguar, se është kërkesë dhe vërejtje e punëtorëve, me i bërë këto pyetje dhe kisha dëshiruar që në mbledhjen tjetër me e pasur një përgjigje prej njerëzve kompetentë për pyetjet e parashtruara.

Qëndron Kastrati, kërkesë për Kryetarin, drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit.

Kërkesa ka të bëjë rreth organizimit të ekskursioneve që janë bërë në Prishtinë, dhe po kërkoj që ose të trajtohet në një mbledhje, ose të përgjigjen në raport me kërkesat me shkrim që i kam bërë. Çështja e dytë, ka të bëjë me tërheqjen e lojërave "Lunapark" nga disa hapësira, ku nuk kanë qenë të përshtatshme që të zhvillohet ajo veprimtari, por është shqetësuese pse nuk është caktuar asnjë lokacion, që t'u mundësojmë atyre që t'i shfrytëzojnë ato hapësira dhe të ketë qyteti lojëra "Lunapark".

Çështja tjetër është çështja e banesave në lagjen "Kodra e Diellit", që janë ndarë nga Komuna, në përgjithësi për drejtorët e Komunës, ka të bëjë me vendime të prera të gjykatave, ku kam kërkuar me shkrim nga kryetari dhe kryesuesi, që të jetë në një prej pikave të mbledhjes së Kuvendit.

Çështja tjetër është pranimi i dokumenteve të këshilltarëve nga ana e Zyrës së Kuvendit. Kërkoj nga Zyra e Kuvendit, që materialet - dokumentet që kanë të bëjnë me afat kohor, siç janë dokumentet që dërgohen nga gjykatat, nuk duhet lënë në dollap, por ato t'i dorëzohen personalisht këshilltarit, dhe me rastin e pranimit nga ana e këshilltarit të nënshkruhet në librin e protokollit. Pra, këto vendime të bëhen me pranim - dorëzim nga këshilltari në fjalë.

Një çështje tjetër, që e kam ngritur edhe në të kaluarën, ka të bëjë me faillet, sidomos dokumentet që janë nga Urbanizmi, që po janë në kapacitet pak më të madh dhe nuk po na dërgohen hiq në formë elektronike, por vetëm përmes CD-ve. Me teknologjinë e sotme është shumë e lehtë ajo, ato mundën me u bart në një server, ku ju lejohet qasje vetëm asamblistëve, që të mos jenë për publikun pa u nxjerrë vendimet.

Çështja tjetër ka të bëjë me Drejtorinë e Shërbime Publike, me ndryshimet që do të ndodhin në mirëmbajtjen e mbeturinave në qytet, d.m.th. është obligim prej nivelit qendror që arkëtimi do të fillojë nga Komuna dhe po kërkoj nga ju si drejtor, edhe prej kryetarit, të ndërmerren hapa, sepse mund të vijmë në një situatë ku ajo ndërmarrje do të shuhet dhe 500 punëtor mund të mbesin pa punë. Është mirë me punuar në atë drejtim, dhe jam dakord, nëse është Feimi uzurpator në atë ndërmarrje, edhe unë jam dakord që, në fund të fundit, për shërbim ndaj qytetarëve mund të angazhojmë edhe kompani private.

Çështja tjetër ka të bëjë me diskutim, që e kemi pasur në mbledhjet e kaluara, është formimi i një grupi prej këshilltarëve të Kuvendit dhe ekzekutivit, kushdo qoftë, për rregullore të veçantë me nxjerrë Kuvendi për dy kategori. Janë kategoritë e luftës, që janë të specifikuara me ligj dhe kategoria për të verbër, sepse, sinqerisht, nuk janë duke u trajtuar sipas ligjit. Ka nevojë për specifikim të mëtutjeshëm, që mund ta trajtojmë në Komunë.

Hatixhe Latifi - Pupovci, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Në lagjen "Kodra e Diellit", afër Shtëpisë së Shëndetit, ndalen dhe parkohen autobusët. Kjo dukuri po i shqetëson banorët përreth për shkak të zhurmës që krijojnë. Ndoshta do të duhej pasur një lokacion ku do të ndaleshin autobusët dhe nuk do t'i pengonin qytetarët.

Tjetra çështje ka të bëjë me pastrimin e qytetit me rastin e festave, ose tubimeve të mëdha në qytet. Ajo çka ka qenë me rastin e festës 28 Nëntori, vërtetë ka qenë e tmerrshme ajo që është parë në sheshet e qendrës së Prishtinës, shportat e mbeturinave kanë qenë përplot me mbeturina. Kur dihet që ka frekuencim më të madh të qytetarëve, atëherë duhet të planifikohet që zbraza e atyre shportave të letrës, që janë të parapara për mbeturinat e dorës, të pastrohen disa herë brenda ditës, e të mos krijohet ajo pamje në qendër të qytetit.

Pika e njëmbëdhjetë

Të ndryshme

Shefki Gashi ngriti një shqetësim, duke thënë se në një asociacioni, apo bashkimi "Gratë për gra", në një forum të gruas që është mbajtur në fshatin Mramor, ku për afërsisht aty ishin më se 100 e sa gra, ato treguan që kanë kërkuar për këtë lokalitet sigurimin e ujit, rrjetin e ujësjellësit, dhe lirim të pronës për kalimin e gypave.

Mirlinda Sopi (pyetje për kryesuesin).

Si është procedura e sistemimit të asamblistëve të rinj nëpër komitete jo obligative. Çka duhet me ndjek për të mundur me u kyçur nëpër komitete, që me e dhënë kontributin e tyre aty ku janë.

Kryesuesi tha se është numri i caktuar për anëtar të komitetit, secili subjekt politik e ka një përfaqësues, nëse është hequr ndonjëri prej juve, ju e propozoni dhe ne e inkorporojmë në vendim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:33.

Procesmbajtësja
Luljeta Selimi